



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 3 paragrafi (d) të Rregullorës 2001/19 mbi degen e ekzekutivit të institucioneve të përkohëshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

Me qellim të veprimit preventiv të zbatimit efikas dhe të drejt të dispozitave ligjore ,të cilat përcaktojnë kriteret për shfrytëzuesit e skemave të mirëqenies sociale të MPMS-së Sekretari i Përhershëm i MPMS-së nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR 01/2005
PËR
FUSHËSHVEPRIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSISË SE KONTROLLËS SE
PAVARUR TË SKEMAVE TË MIRËQENIES SOCIALE TË MPMS-së**

Neni 1

Qellimi i Udhëzimit Administrativ

- 1.1** Qellimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të rregulloj dhe përcaktoj fushëveprimin,detyrat,përgjegjësitë ,kompetencat dhe elementete e tjera të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe avansimin e punës e aktiviteteve të njesisë se kontrollës se pavarur të skemave të mirëqenies sociale të MPMS-së.

Neni 2

Njësia e kontrolles se pavarur

- 2.1** Njësia e kontrolles së pavarur të skemave të mirëqenies sociale, është një structure organizative e cila vepron dhe punon në kuader të Zyrës se Sekretarit të përhershem të Ministrisë se punës dhe mirëqenies sociale.

Neni 3

Misioni i njësisë se pavarur të kontrollit

- 3.1** Misioni themelor i njësisë se pavarur të kontrollës se pavarur të skemave të mirëqenies sociale është parandalimi i veprimeve të kundërligjshme në skemat e mirëqenies sociale dhe ofrimi i shërbimeve dhe ndihmes profesionale në zbatimin e drejt dhe efikas të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë skemat e mirëqenies sociale të MPMS-së.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë se kontrollit të pavarur

- 4.1** Njësia e kontrolles se pavarur të skemave të mirëqenies sociale në MPMS është përgjegjës për;
- Ndalimin dhe parandalimin e dukurive dhe veprimeve të kundërligjshme në skemat e mirëqenies sociale të MPMS –së.
 - Përkujdesjen dhe monitorimin e zbatimit të drejtë të Legjislacionit primar dhe sekondar I cili rregullon dhe normon skemat e mirëqenies sociale të MPMS-së.
 - Vlersimin e zbatimit të kriterëve ligjore përkitazi me njohjen e të drejtave parashtruesve të kerkesave për ndonjëren prej skemave të mirëqenies sociale
 - Hulumtimin dhe grumbullimin e të dhenave dhe informacioneve tjera lidhur me shkeljet ligjore me rastin e njohjes se të drejtave në skemat e mirëqenies sociale .
 - Njoftimin me mendimet dhe opinionet e zyrtarëve të MPMS –së, shoqërisë civile dhe qytetarëve përkitazi me zbatimin e skemave të mirëqenies sociale të MPMS.
 - Kontrollimin e skemave të mirëqenies sociale duke u bazuar në konceptin dhe politikat e MPMS –së.
 - Shfrytëzimin e të dhenave të DAPK, dhe njesive thëra organizative të MPMS –së, për nevojat e kontrolles se skemave të mirëqenies sociale.
 - Kontrollimin e të gjitha skemave të mirëqenies sociale, sipas propozimeve të klientelles se MPMS, dhe stë:
 - Skemen e ndihmes emergjente
 - Skemen e pensioneve bazë

- Skemen e përsoneve më aftësi të kufizuara
 - Skemen e invalidëve të luftës,dhe për të afermit e tyre
 - Skemen e pensioneve të parakoheshme për minatoret e Kompleksit,„Trepça” si dhe
 - Të gjitha skemat e tjera të cilat do të implementoi MPMS.
- Hartimin dhe përpelimin e analizave,raporteve periodike dhe vlersimeve të ndryshme nga kjo lemi për nevojat e MPMS –së .
 - Konstatimin e parregullesive dhe propozimin e masave ndeshkuese ndaj eproreve dhe nëpunësve të MPMS-së të cilat janë përgjegjës për këto parregullesi
 - Të gjitha angazhimet dhe aktivitetet e tjera të cilat janë të nderlidhura ne skemat e mirëqenies sociale të MPMS-së.

Neni 5

Funksionimi

5.1 Për funksionimin e drejt dhe efikas të njësisë se kontrolles se pavarur të skemave të mirëqenies sociale është përgjegjës Kryesuesi i njësise se kontrolles se pavarur,dhe zyrtaret tjerë të pavarur për kontrollin e skemave të mirëqenies sociale të MPMS-së. Për punën dhe aktivitetet e tyre kontrolloret e pavarur i raportojnë Kryesuesit të njësisë se kontrollit të pavarur.

Neni 6

Mbikëqyrja dhe raportimi

6.1 Fushëveprimin e njësisë se kontrollit të pavarur të skemave të mirëqenies sociale e mbikqyrë Sekretari i Përhershëm i MPMS –së apo nëpunësi të cilin e autorizon ai. Për punën e vet dhe fushëveprimin e njësisë se kontrollit të pavarur i përgjigjet dhe i raporton Sekretarit të përhershëm

Neni 7

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve

7.1.Për realizimin e punëve në menyre të efektshme ,njësia e kontrolles se pavarur për skemat e mirëqenies sociale,përhere duhet te komunikoj dhe bashkërendis punet dhe aktivitetet në strukturat tjera organizative të MPMS-së,veqmas me DAPK dhe DMS të MPMS –së.

Neni 8

Përshkrimi i vendeve të punës

8.1 Pjesë integrale e këtij Udhëzimi Administrativ,ku janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit e njesisë se kontrollit të pavarur ,janë dhe detyrat e Zyrtarëve të kësaj njësie .

Neni 9

Rregullimi i qeshtjeve tjera

9.1 Për avansimin dhe përparimin e punës se njesisë se kontrollit të pavarur ,Sekretari i Përhershem i MPMS –së mund të nxjerr akte tjera nenligjore ,të cilat duhet të jenë në pajtim më këtë Udhëzim Administrativ

Neni 10

Hyrja në fuqi

10.1 Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi,me nenshkrimin nga Sekretari i Përhershem i MPMS –së

Prishtinë,janar 2005

**Sekretari i Përhershem i MPMS –së
Ramiz Fazliu**
